



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 25/15

Prishtinë, më 08.07.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjonaj dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Frank Lakwjik – Përfaqësues i Përhershëm i Zyrës së FMN-së në Kosovë, Selim Thaqi – ekonomisë në Zyrën e Përheshme të FMN-së në Kosovë, Berat Begu – Udhëheqës Divizioni në BQK, Zyber Gadrailu – Zyrtar i lartë Ligjor në BQK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Ismaili nga GIZ, monitorues nga USAID, Projekti Partnerships for Development, OSBE, Hulumtues nga GAP, Gazetar nga Kosova Sot, RTV21, Kosova Pres, Tribuna Channel, BIRN, dhe KosovaLive.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 23.6.2015 dhe 1.7.2015;**
3. **Informatë lidhur me marrëveshjen e negociuar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për Programin e ri;**
Të ftuar:
Avdullah Hoti, Ministër i Financave, dhe
Frank Lakwjik, Përfaqësues i Përhershëm i Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë,
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 05/L-045 për Sigurimet;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-22 për Armë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore**

për Siguri dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – kryetari konstaton se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 23.6.2015 dhe 1.7.2015

Kryetari – kryetari konstaton se komisioni njëzëri miratoi procesverbalet pa vërejtje.

3. Informatë lidhur me marrëveshjen e negociuar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për Programin e ri

Kryetari – Komisioni, ka pranuar draft marrëveshjen e arritur në mes Qeverisë dhe FMN-së për programin e ri. Megjithatë, është vlerësuar e nevojshme, që anëtarët e komisionit, më përse afërmi, të njoftohen për kushtet dhe kërkesat, obligimet dhe përgjegjësitë institucionale-shtetërore dhe benefitet, që dalin nga ky program. Kjo marrëveshje e arritur dhe ky informim do të shërbej edhe me hartimin e buxhetit për 2016, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me nivelin e shpenzimeve, nivelin e deficitit buxhetor dhe bilancit, apo rezervës bankare, si dhe për nevojën e ndryshimit apo rritjen e rregullës fiskale. Një çështje e diskutuar gjatë me FMN-në është nevoja për ndryshimin e kësaj rregulle që nënkupton edhe ndryshimin e ligjit. Rishikimi i buxhetit 2015, parasheh shkurtime në bazë edhe të marrëveshjes që është arritur. Prandaj, takimi i sotëm, ka për qëllim që nga të ftuarit të marrim informata dhe të dhëna lidhur me këtë program, i cili do të ketë refleksione në 22 muajt e ardhshme në sistemin e financave publike në Kosovë.

Avdullah Hoti – si qeveri e kemi marr iniciativën për këtë program për të ndihmuar agjendën zhvillimore dhe përmbajta e këtij programi me FMN-në reflekton objektivat e qeverisjes. Për shkak të buxhetit me të hyra të mbi vlerësuara, qeveria qysh në fillim i ka theksuar kufizimet. Ne e kemi përcjell dinamikën e tremujorit të parë të këtij viti dhe kemi sjell rishikimin e buxhetit në mënyrë që buxheti të jetë në terma reale, si dhe për ti planifikuar shpenzimet aq sa i kemi të hyrat. Në programin e qeverisë ka projekte të mëdha investive të cilat nuk mund të implementohen me buxhetin të cilin e kemi. Jemi pajtuar me misionin e FMN-së mbi bazën e respektimit 2% të deficitit buxhetor për buxhetin e rregullt dhe tejkalimin e këtij deficiti vetëm për investime kapitale. Më tutje, jemi pajtuar për një agjendë të detajuar të ndryshimeve legislative dhe reformave tjera që duhet të ndodhin të cilat do të ndihmojnë në implementimin e programit qeverisës. Jemi pajtuar në terma të përgjithshme për buxhetin e vitit 2016, por do të bisedojmë prapë në shtator dhe në fillim të tetorit lidhur me këtë çështje. Po ashtu, jemi pajtuar në terma të përgjithshme për shpenzimet rrjedhëse, deficitin buxhetor në përputhje me ligjin, financat publike, bilancin bankar. Më tutje, jemi pajtuar për një varg të reformave strukturore që duhet të ndodhin sa i përket masave për të nxitur rritjen ekonomike, për të eliminuar burokracinë, për të rrit transparencën, si dhe për të përmirësuar qeverisjen, siç është ndryshimi i ligjit për prokurim publik ose aplikimi i plotë i prokurimit elektronik. Programi me FMN-në na mundëson kredi me norma konsesionare për të implementuar projekte kapitale përtej 2% për aq kohë sa borxhi publik është nën 30%. Gjithashtu, jemi pajtuar që të identifikojmë një listë të projekteve të mëdha kapitale që kanë ndikim social dhe ekonomik. Në Kuvend duhet të raportojmë në baza tre mujore për implementimin e

këtyre projekteve të mëdha kapitale. Janë edhe një sërë masash tjera të reformave strukturore si për shembull kompletimi i bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i cili na mundëson të përdorim menjëherë disa mjete që janë të lira nga fondi i privatizimit edhe masa tjera. Dëshirojmë ta bëjmë rritjen e pagave në sektorin publik në baza vjetore, me një formulë duke marr parasysh elementet e formulës që janë rritja ekonomike, rritja e buxhetit, rritja e inflacionit vjetor, si dhe indikator tjerë. Ne nuk po hyjmë në këtë program për shkak problemeve fiskale, por për të pas mundësi zhvillimore, si dhe për të imponuar një disiplinë fiskale, ndërkohë duke rritur kredibilitetin e institucioneve vendore karshi partnerëve ndërkombëtar.

Frank Lakwjik – pajtohem plotësisht me çdo gjë që u tha nga Ministri. Mendoj se ishte një pasqyrë korrekte dhe shumë mirë e detajuar e programit të qeverisë të cilin FMN tani mund ta mbështesë. Ishte një qasje shumë e mirë për Qeverinë që të veproj sipas kësaj trajektore dhe së pari të vendos vet se çka ajo dëshiron e pastaj të kërkoj ndihmën tonë në detaje të saj. Ky rishikim i buxhetit në mes të vitit është rishikim realist, ndërsa buxheti i vitit 2015 që është dashtë të miratohet shumë shpejt nuk ka qenë real.

Ilir Deda – buxheti i votuar për vitin 2015 ka qenë jo mirë i planifikuar dhe mirë është që po ndërron. Një diskrepancë e cila ekziston në kuptimin e fjalës siç na është shpjeguar neve është se FMN me investim kapital nënkupton investim zhvillimor, jo infrastrukturë dhe kjo duhet të sqarohet. Dy pika të cilat mund të ngjallin mosbesim, njëra ka të bëjë me prokurimin e centralizuar i cili mund të krijoj një monopol të ri në Kosovë. Apeloj te ju zoti Ministër që ti ndërmerrni të gjitha masat që grupi i cili do të punojë për prokurimin e centralizuar, të jetë sa më gjithëpërfshirës, si dhe vendimi të jetë sa më transparent. Shifra e huamarrjes mund të këtë qëllim të mirë, por kisha apeluar që ato para të analizohen dhe të diskutohen në një grup sa më gjithëpërfshirës politik dhe shoqëror, që të destinohen për zhvillim të mirëfilltë të Kosovës. Shpresoj të këtë zhvillim ekonomik i cili është interes i të gjithëve, dhe që të këtë forum gjithëpërfshirës vendimmarrës, për destinimin e mjeteve që do të huazohen, që të krijohet edhe besimi publik dhe ndër shoqëror, që Kosova të del nga kriza e madhe ekonomike.

Kryetari – buxheti ka qenë ambicioz dhe për shkak kohës është dashtë të punohet me atë, por vetëm deri në fazën e rishikimit. Pajtohem që buxheti ka rënë në shuma reale të mundësisë së grumbullimit të të hyrave. Qeveria do të duhet të ishte në nivelin e asaj që vet të ndërhyjë në mënyrë që të kemi kursime sidomos te kategoria e pagave dhe mëditjeve, për të cilin duhet krijuar kushte më realiste në bazë të rrethanave ekonomike në Kosovë, edhe sikur të mos kishte marrëveshje me FMN. Ne ndërkohë kemi punuar shumë me ligjet e pakos fiskale. Prokurimi elektronik i cili ka, krijon mundësi më të mira që ti shmangemi ekonomisë joformale. Një çështje që ndoshta duhet pak më shumë me detalizue është çështja e mjeteve të planifikuara nga AKP, ku kemi një proces të likuidimit. Nuk është bordi organ i fundit që mund të aprovoj derdhjen e mjeteve, por është oda e veçantë në Gjykatë Supreme që e thotë fjalën e fundit. Në rishikimin e buxhetit kemi konstatuar që është një vlerësim shumë modest në krahasim me atë se sa mund të merren prej mjeteve të privatizimit, siç e definon ligji i AKP-së, që këto mjete të shkojnë vetëm në investime kapitale.

Enver Hoti – nuk është e justifikueshme të thuhet se buxhetit ka qenë joreal, megjithatë është mirë që rishikimi i buxhetit ka filluar të jetë në shuma reale. Kam disa pyetje: Çfarë projeksione presim për vitin 2016? Duke pasur parasysh problemet me të hyra nga doganat, rritjen e ekonomisë joformale, çfarë masa do të merren në të ardhmen për ti realizuar projeksionet fillestare të planifikuara nga ana juaj?

Avdullah Hoti – në këtë buxhet të rishikuar nuk janë zvogëluar ato shpenzimet esenciale dhe asnjë projekt kapital nuk është hequr prej listës së investimeve kapitale. Mund të jenë alokuar shumat prej një projekti në projektin tjetër varësisht prej dinamikës që kanë pasur organizatat buxhetore. Kemi arrit të bëjmë kursime në paga dhe mëditje dhe në mallra dhe shërbime, mirëpo asnjëherë nuk është prek cilësia e shërbimeve publike. Masat e politikave fiskale në pakon fiskale besoj që së shpejti do të hynë në fuqi

dhe do të japin disa efekte për të inkasuar të hyra shtesë në buxhet. Qeveria ka aprovuar rregullore për prokurimin e centralizuar. Agjensioni i Prokurimit të Qendror, tani ka marr kompetenca shtesë dhe kjo ka me rritë cilësinë e mallrave dhe shërbimeve dhe ka me ulë koston e tyre. Projektionet fillestare në këtë aspekt, janë që kursimet mund të jenë deri në 7 milion euro, në një list prej gjashtë mallrave dhe shërbimeve. Së bashku me FMN jemi pajtuar që ta zgjerojmë këtë listë dhe të rrisim edhe numrin e organizatave buxhetore jo vetëm të nivelit qendror por edhe të nivelit lokal që kryen prokurime të centralizuara, si dhe ta rrisim listën e mallrave që shkojnë në prokurime të centralizuara. Besoj që tash me këtë program ne po hapim mundësi tjera dhe pres që buxhetin e vitit 2016 ta sjellim para juve me një model komplet të ri duke përfshirë aty këto investimet e mëdha kapitale që i përmendëm. Pse Kredia? Asnjë vend në zhvillim nuk ka shkuar përpara pa kredi dhe është mëkat që ne me mbajt borxhin publik në 10% duke u krenuar me atë, ndërkohë mos me krijue potenciale dhe ato potenciale zhvillimore krijohen edhe duke investuar në rrugë dhe në infrastrukturë. Ne i kemi identifikuar investime rreth 200 milion euro në infrastrukturë që kanë për të zvogëluar koston e transportit. Investimet qindra milionëshe në sistemet e ujitjes, kanë me përgjysmua koston e prodhimit bujqësor. Këto janë objektiva zhvillimore tash nuk e di si mund të shihen prej të tjerëve. Mendoj këto shkojnë drejt objektivës që ne e kemi për zhvillim ekonomik, rritje të punësimit dhe rritjes së të ardhurave.

Kryetari – me qenë se kjo pikë ishte vetëm për informim nga përfaqësuesi i FMN-së dhe nga Ministri i Financave, dhe pasi që nuk ka diskutime tjera, konsiderohet e përfunduar. Komisioni do të vazhdojë takimet në kuadër të procesit të mbikëqyrjes së implementimit të marrëveshjes së qeverisë me FMN për programin e ri në proceset në të ardhmen.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 05/L-045 për Sigurimet

Kryetari - Projektligji për sigurimet përcakton përgjegjësinë e BQK-së për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e siguruesve, ri-siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimit, ri-sigurimit si dhe profesionistëve tjerë të sigurimeve, si dhe për caktimin e standardeve, udhëzimeve, nxjerrjen e rregulloreve, urdhrave dhe udhëzimeve tjera, për këto subjektet. Projektligji rregullon klasat e sigurimit për sigurimet “Jetë” dhe “Jo Jetë” ashtu siç janë të përcaktuara me Legjislacionin e BE-së.

Avdullah Hoti – më qëllim të rregullimit më të mirë ligjor të veprimtarisë së sigurimeve është hartuar projektligji për sigurimet, që është një hap shumë i rëndësishëm në krahasim me rregullores së mëparshme të UNMIK-ut që ka rregulluar këtë sektor. Ky projektligj përmban parime dhe rregullat për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve. Kjo është bërë me qëllim, që industria e sigurimeve në republikën e Kosovës të bëjë një sigurim të qëndrueshëm e transparentë, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të të licencë-marrësve dhe ne funksion të objektivave të Bankës Qendrore të Kosovës. Arsyeshmëria e hartimit të këtij Projektligji i referohet avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore sipas praktikave ndërkombëtare, të kësaj industrie, po ashtu i referohet edhe mbrojtjes së konsumatorit, Ky projektligj në masë të konsiderueshme është në harmoni me direktivat e BE-së.

Berat Begu - projektligji është përgatitur në bazë të direktivave evropiane dhe duke u konsultuar me të gjitha palët e interesit, si kompanitë e sigurimeve dhe gjitha palët tjera të ndryshme. Elementet kryesore të projektligjit janë mbikëqyrja e sigurimeve dhe të kompanive të sigurimeve. Po ashtu Projektligji i është dërguar Zyrës së BE-së në Prishtinë për të vlerësuar harmonizimin me direktivat e BE-së dhe përgjigjet e tyre ka qenë se projektligji është në harmoni me direktivat evropiane, ka pjesë që nuk janë në harmoni të plotë me direktivat evropiane, por që nuk janë në kundërshtim me këto direktiva dhe është e lejueshme për shtetet joanëtare. Po ashtu, në hartimin e këtij projektligji përdorur edhe parimet e organizatës ndërkombëtare të mbikëqyrësve të sigurimeve, janë konsultuar edhe ligjet e Sllovenisë dhe të rajonit.

Kryetari – ne kemi edhe opinionin e ministrisë së financave, që vlerëson se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Zyber Gadrailiu - projektligji parasheh edhe mundësinë e krijimit të të hyrave, për arsye se nëse kompanitë e sigurimeve bëjnë shkelje ligjore, BQK mund të shqiptojë gjoba dhe në këtë mënyrë krijohen të hyra, e cila ka me u trajtu me rregullore te brendshme që do ti nxjerr BQK.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Nait Hasanit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Ilir Deda - desha t'iu informojë se Komisioni për Integritet Evropian, nuk e ka përkrahur amendamentin e dytë të deputetit Nait Hasani, i cili parashikon identifikimin e përkatësisë etnike në letërnjoftim sepse nuk është me praktikën bashkëkohore, dhe identiteti nacional nuk shkruhet në dokumentet e udhëtimit.

Kryetari – Komisioni për Buxhet dhe Financa e vlerëson koston buxhetore, prandaj edhe ky amendamentet i deputetit nuk përmban kosto shtesë buxhetore dhe ne e vlerësojmë kështu, ndërkaq seanca vendos për miratimin apo mosmiratimin e tij.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Nait Hasani, për Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-22 për Armë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-22 për Armë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për Projektligjin nr.05/L-22 për Armë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatese të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Ilir Deda - unë jam kundër projektligjit, pasi që për këtë projektligj ka shumë vërejtje nga mediat.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni me tetë vota Për, një Kundër (Ilir Deda) dhe Asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Të ndryshme

9.1. Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit se komisionet tjera të përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale, Projektligjin për tatimin në të ardhurat e

korporatave dhe Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe amendamentet e propozuar nga komisioni ynë dhe kanë vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe nuk i cenojnë dhe prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Prandaj, kërkohet dhe propozojë që të votojmë raportet finale për të tri projektligjet dhe të njëjtat të procedohen për miratim në Kuvend.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratonte Raportet finale për Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave, Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, dhe të njëjtat i procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

9.2. Kryetari – duke pasur parasysh faktin se në seancën plenare të nesërm është radhitur për shqyrtim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit 2015 dhe rekomandim është që kjo të bëhet me shmangie, si në leximin e parë dhe të dytë, kjo për shkak të marrëveshjes me FMN. Prandaj, nëse miratohen rekomandimet e komisionit, ne do të kemi shumë pak kohë për shqyrtimin e rishikimit të buxhetit, propozojë që të krijojmë një grup punues, i cili do të punojë intenzivisht dhe të përgatit propozim amendamentet eventuale për komisionin, në mënyrë që pastaj të procedojmë raportin në komisionet tjera të përhershme dhe në Kuvend, brenda afateve.

Sipas propozimit, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

I. Caktohet grupi punues për shqyrtimin Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Latif Gashi, Besa Gaxherri dhe Enver Hoti.

II. Grupi punues përgatit raportin me rekomandime për Komisionin.

Mbledhja përfundoi në ora 12:04

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani